



KOMPANIJA RAJONALNE UJESJELLENJE SH.A  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C  
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVODI D.O  
**MITROVICA**  
TEL/FAX: 045433-787, 220-304


Nr. 21-697

Data: 18.04.2024

## **K.R.U. MITROVICA SH.A.**

### **RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE**

Me dhe për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRAT E FINANÇARË - MINISTARSTVO FINANCJE - MINISTRI OF FINANCE A ÇSHLLI I KOSOVËS PËR RAPORTIN FINANCIAR KOSOVBET SAJET ZA FINANSIJSKO IZVEŠTAVANJE KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL
Nr./Br.No. <u>153</u>	Nr./No./Br./No. pp. _____
Date/Datim/Date <u>18.04.2024</u>	_____
PRISHTINE - PRISTINA - PRISHTINA	



**MITROVICA**

KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.


**K.R.U. MITROVICA SH.A.**

Mitrovicë, rr. Liqenit, p.n.  
NUI: 810364852

**DEKLARATË E PAJTUESHMËRISË**

- Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2023 -

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2023 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në Pajtim me të gjitha kërkesat e ligjit 06-/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

  
**Emine Peci Mahmuti**  
U.D. Kryeshef Ekzekutiv



  
**Niman Baliu**  
U.D. Drejtor Financiar

## PËRMBAJTJA:

RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR.....	4
RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE.....	7
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	8
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE.....	9
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET.....	10
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË.....	11
1. Informata të përgjithshme.....	12
2. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël.....	12
3. Adoptimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe Interpretimi i tyre.....	21
4. Prona, pajisjet dhe makineritë.....	23
5. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera.....	24
6. Stoqet.....	24
7. Paraja dhe ekuivalentët e saj.....	24
8. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera.....	24
9. Detyrimet tjera afatgjata.....	25
10. Kapitali aksionar.....	25
11. Të hyrat.....	25
12. Kosto e mallit të shitur.....	28
13. Shpenzimet e shpërndarjes.....	26
14. Shpenzimet e personelit.....	26
15. Shpenzimet administrative – komunalitë.....	27
16. Shpenzimet administrative - tjera.....	27
17. Shpenzimet financiare.....	27
18. Shpenzimet e tatimit në fitim.....	28
19. Transaksionet me palët e lidhura.....	28
20. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut.....	29
21. Kontigjencat dhe zotimet.....	31
22. Ngjarjet pas datës së raportimit.....	31

## RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR

Për aksionarët dhe menaxhmentin e K.R.U. MITROVICA SH.A.

### Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të K.R.U. Mitrovica SH.A. ("Kompania") të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2023 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekulitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç çështjeve të përshkuara në "*Bazën për Opinion me Rezervë*", Pasqyrat Financiare të bashkangjitura paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare me 31 dhjetor 2023 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për opinion me rezervë

- Siç është shpalosur në shënimin 5, Prona, Implantet dhe Pajisjet me 31 dhjetor 2023 janë në vlerë 23,690,792 Euro dhe me 31 dhjetor 2022 janë në vlerë 24,162,675 Euro. Kompania nuk e ka rishikuar asnjëherë vlerën e drejtë të asetëve siç kërkohet me modelin e Rivlerësimit nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 16 Pasuritë Afatgjata Materiale ("SNK16"). Në përputhje me kërkesat e SNK16 rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt mjaftueshëm që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e pasurisë nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e bilancit. Ne nuk ishim në gjendje përmes procedurave alternative të auditimit të vlerësojmë se vlera bartëse e Pronës, Implantëve dhe Pajisjeve është prezantuar në përputhje me kërkesat e SNK16.

- Siç është shpalosur në shënimin 6 të Pasqyrave Financiare, llogaritë e arkëtueshme tregtare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 janë 26,156,905 Euro dhe me 31 dhjetor 2022 në vlerë 25,871,367 Euro. Kompania ka të arkëtueshme në vlerë prej 18,136,488 Euro me 31 dhjetor 2023 për faturimin me shumicë kryer Komunës Veriore të Mitrovicës për banorët e pjesës veriore të Mitrovicës. Nga testimet tona faturat që ju dërgohen Komunës respektive ato nuk pranohen dhe kështu bëhen edhe të pamundshme për të bërë përpjekje që të kërkohen përmes procedurave ligjore. Këto çështje japin indikacion të qartë që kompania do të duhej të kryente vlerësim më të thëllë për provizionimin e Llogarive të Arkëtueshme. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të vërtetojmë nëse Kompania do jetë në gjendje të inkasojë vlerën e llogarive të arkëtueshme të prezantuara.

Kompania nuk ka analiza të mjaftueshme të cilat mbështesin parashikimet e menaxhmentit të bëra në relacion me balancën e provizionit të borxheve të këqija dhe të dyshimta. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare të Kompanisë më 31 dhjetor 2023. Për më tepër, Kompania nuk ka aplikuar në tërësi kërkesat që dalin nga SNRF 9 në lidhje me provizionimet e llogarive të arkëtueshme. Në mungesë të analizave historike të kërkuara nga SNRF 9 dhe përcaktimin e modelit të kalkulimit të provizioneve në llogaritë e arkëtueshme ne nuk mund të vlerësojmë se sa do mund të jetë efekti në provizionim nëse do të përfillin në tërësi kërkesat që dalin nga SNRF 9 në kalkulimin e provizionit.

- Siç është shpalosur në shënimin 7 të Pasqyrave Financiare, stoqet për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 janë 251,509 Euro dhe me 31 dhjetor 2022 në vlerë 264,537 Euro. Kompania nuk ka aplikuar ndonjë politikë në lidhje me vlerësimin e stoqeve për të përcaktuar vlerën e drejtë të stoqeve siç e kërkon Standardi Ndërkombëtar I Kontabilitetit 2 Inventarët. Për shkak të natyrës së shënimeve financiare të mbajtur nga Kompania, ne nuk ishim në gjendje duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të vërtetojmë efektin e mundshëm që mund të rrjedhë mbi pasqyrat financiare në rast se ndodhë ndonjë shlyerje apo provizionim i këtyre saldoeve.
- Siç është shpalosur në shënimin 9, Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera janë në vlerë 4,935,742 Euro me 31 dhjetor 2023 dhe 5,046,592 Euro me 31 dhjetor 2022. Pjesë përbërëse e kësaj llogarie është edhe TVSH e pagueshme me 31 dhjetor 2023 në vlerë 3,547,974 Euro dhe me 31 dhjetor 2022 në vlerë 3,574,938 Euro. Kjo llogari paraqet TVSH e pagueshme të cilës Kompanisë i bartet nga koha kur TVSH është paguar nga Kompania me rastin e Inkasimit të faturimit, pas ndryshimit të ligjit Kompania nuk ka kryer rregullimet në Pasqyrat Financiare dhe kështu ka mbivlerësuar Detyrimet Afatshkurtra të Kompanisë.

Ne kemi kryer auditimin në pajtuesmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raportit.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtuesmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtuesmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përftuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

#### **Çështjet tjera**

- Kompania për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 ka kryer auditimin e pasqyrave financiare me një auditor tjetër i cili ka shprehur mohim opinionit.

#### **Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtuesmëri me SNRF dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likullojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

### **Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomallive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomallive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijmësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasniqi  
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. L.L.C  
28 mars 2024



## RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të K.R.U. MITROVICA SH.A. si dhe informacionin e shkruar ne raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10. Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 për pavaresinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.

### Raport mbi kërkesat tjera

- Ne jemi angazhuar si auditor te kompanisë K.R.U. MITROVICA SH.A. për periudhën 01 janar 2023 - 31 dhjetor 2023, me datë 14 dhjetor 2023 përmes Prokurimit Publik.
- Si pjesë e auditimit ne kemi identifikuar dhe vlerësuar rreziqet më të rëndësishme të anomalive materiale, duke përfshirë rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit. Më poshtë janë paraqitur rreziqet e rëndësishme dhe përgjigja e auditorit ndaj këtyre rreziqeve.

#### *Vlerësimet kontabël*

Kompania përdor vlerësimet kontabël në fusha të rëndësishme të pasqyrave financiare përfshirë jetëgjatësinë e aktiveve, dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe njohjen e provizioneve nga çështjet e mundshme gjyqësore. Përcaktimi i politikave lidhur me vlerësimet kontabël bëhet bazuar në përvojën historike dhe ndryshimet në faktorët ekonomik dhe të industrisë.

#### *Përgjigja e auditorit*

- o Vlerësimi i përshtatshmërisë së vlerësimeve kontabël,
  - o Vlerësimi i arsyeshmërisë së supozimeve të bëra nga menaxhmenti,
  - o Rishikimi i saldove dhe rillogaritja e shumave të përdorura në supozime dhe metoda për të arritur në vlerësimet kontabël.
- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.
  - Ne konfirmojmë që opinionin e auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit.
  - Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në UA nr.02/2019 për pavaresinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

Lulzim Krasniqi  
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. L.L.C.  
28 mars 2024



**K.R.U. MITROVICA SH.A.**  
**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**  
 Me 31 dhjetor 2023  
 Të gjitha shumat në Euro

<b>ME 31 DHJETOR</b>		<b>2023</b>	<b>2022</b>
	<i>Shënimi</i>	<b>€</b>	<b>€</b>
<b>PASURITË</b>			
<b>Pasuritë afatgjata</b>			
Prona, pajisjet dhe implantet	4	23,690,792	24,162,675
Investimet në vijim	4a	90,676	90,676
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>23,781,468</b>	<b>24,253,351</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	26,156,905	25,871,367
Stoqet	6	251,509	264,537
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	203,808	32,081
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>26,612,222</b>	<b>26,167,985</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>50,393,690</b>	<b>50,421,336</b>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	4,935,742	5,046,592
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>4,935,742</b>	<b>5,046,592</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Detyrimet e tjera afatgjata	9	17,927,247	17,900,882
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>17,927,247</b>	<b>17,900,882</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>22,862,990</b>	<b>22,947,473</b>
<b>EKUITETI</b>			
Kapitali aksionar	10	26,490,000	26,490,000
Fitimet e mbajtura		1,040,700	983,863
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>27,530,700</b>	<b>27,473,863</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>50,393,690</b>	<b>50,421,336</b>

Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe aprovuar nga menaxhmenti i K.U.R. MITROVICA SH.A. dhe janë nënshkruar më 23 shkurt 2024 në emër të:



**Emine Peci Mahmuti**  
 U.D. Kryeshf Ekzekutiv



**Niman Baliu**  
 U.D. Drejtor Financiar



**Emine Peci Mahmuti**  
 Kontabilist i Çertifikuar

*Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*



**K.U.R. MITROVICA SH.A.**  
**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**  
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023  
*Të gjitha shumat në Euro*

	<i>Shënimi</i>	<b>Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023 €</b>	<b>Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022 €</b>
Të hyrat	11	5,026,688	5,139,898
Kostoja e shitjes	12	(738,938)	(659,702)
<b>Fitimi / (humbja) bruto</b>		<b>4,287,750</b>	<b>4,480,196</b>
Të ardhurat tjera	11	1,399,008	1,639,135
Shpenzimet e shpërndarjes	13	(2,589,618)	(2,480,465)
Shpenzimet e personelit	14	(2,212,798)	(1,998,927)
Shpenzimet administrative - Komunalitë	15	(781,609)	(737,272)
Shpenzimet administrative tjera	16	(590,670)	(797,921)
<b>Fitimi / (humbja) operativ</b>		<b>(487,938)</b>	<b>104,745</b>
Shpenzimet financiare	17	(9,044)	(19,157)
Të ardhurat financiare			
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b>(496,982)</b>	<b>85,589</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	18	-	-
<b>Fitimi / (humbja) l/e vitit</b>		<b>(496,982)</b>	<b>85,589</b>

*Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**K.U.R. MITROVICA SH.A.**  
**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**  
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023  
*Të gjitha shumat Euro*

	<b>Kapitali aksionar €</b>	<b>Fitimet e mbajtura €</b>	<b>Gjithsej €</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>26,490,000</b>	<b>898,274</b>	<b>27,388,274</b>
Fitimi / (humbja) l/e vitit		85,589	85,589
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>26,490,000</b>	<b>983,863</b>	<b>27,473,863</b>
Fitimi / (humbja) l/e vitit		(496,982)	(496,982)
Ndryshimi ne vitet e kaluara		553,819	553,819
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>26,490,000</b>	<b>1,040,700</b>	<b>27,530,700</b>

**K.U.R. MITROVICA SH.A.**  
**PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË**  
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023  
Të gjitha shumat Euro

<b>Pershkrimi</b>	<b>2023</b>	<b>2022</b>
	<b>€</b>	<b>€</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	(496,982)	85,589
<b>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</b>		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	2,471,861	2,375,183
Shpenzimet financiare	9,044	19,157
	<b>1,983,923</b>	<b>2,479,928</b>
<b>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</b>		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(285,538)	(1,087,470)
(Rritja) / zvogëlimi në stocqe	13,028	(7,318)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	(110,850)	(176,647)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	26,367	(1,255,555)
	<b>(356,993)</b>	<b>(2,526,990)</b>
Interesi i paguar	(9,044)	(19,157)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>(9,044)</b>	<b>(19,157)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(1,999,978)	(6,215)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>	<b>(1,999,978)</b>	<b>(6,215)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Ndryshimi në vitet e kaluara	553,819	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>553,819</b>	<b>-</b>
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>	<b>171,727</b>	<b>(72,433)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	32,081	104,514
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>203,808</b>	<b>32,081</b>

*Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**K.R.U. MITROVICA SH.A.****SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME**

K.R.U. MITROVICA SH.A. është një shoqëri aksionare që u regjistrua në agjencinë e regjistrimit të bizneseve në Kosovë më 29 maj 2007 me numrin e regjistrimit të biznesit 70433740 dhe numër unik identifikues 810364852. Zyra qendrore e kompanisë është e vendosur në Mitrovicë, rr. Liqenit, p.n.

Aktiviteti e kompanisë sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK):

<b>Kodi</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Tipi</b>
3600	Grumbullimin, trajtimin dhe furnizimin me ujë	Primarë
4313	Testi i shpuarjes dhe shpuarja	Sekon

Gjatë vitit 2023 Kompania kishte mesatarisht 261 të punësuar (2022: 261 punëtorë).

Pronar i Kompanisë është Qeveria e Kosovës me 100% të aksioneve.

**2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL****2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare të ndërmarrjes për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Pasqyrat financiare SNRF të Ndërmarrjesë përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në ekulitet, pasqyra e rrjedhës së parasë, politikat e rëndësishme kontabël dhe shënimet për pasqyrat financiare.

**2.2 Bazat e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nën parimin e kostos historikedukë përfshië Pronat, Implantet dhe Pajisjes e bartuar në rastin e korporatizimit në vitin 2007 të cilat konsiderohen të jenë kosto në vitin e inkorporimit. Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro ("Euro"), e cila është monedha funksionale e Ndërmarrjesë.

**2.3 Parimi i vijmësisë**

Menaxhmenti i Ndërmarrjes vlerëson se ekziston aftësia e ndërmarrjes për të vazhduar biznesin dhe operacionet e saj dhe është i kënaqur që ka burime të mjaftueshme për të vazhduar biznesin e saj për një të ardhme të parashikueshme. Për më tepër, menaxhmenti nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Ndërmarrjesë për të vazhduar aktivitetin. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të jenë të përgatitura në bazë të parimit të vijmësisë.

**K.R.U. MITROVICA SH.A.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**2.4 Prona dhe pajisjet**

i. Njohja dhe matja

Ndwmarrja zbaton modelin e koston konform kwrkesave tw SNK 16. Zërat e pronës dhe pajisjeve më 1 janar 2007 janë paraqitur me koston e konsideuar të reduktuar për zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, përfshirë edhe zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve më 1 janar 2007 të cilat paraqiten me koston e konsideruar të reduktuar për zhvlerësimin dhe dëmtimin. Kostoja përfshinë shpenzimet që janë drejtpërdrejtë të lidhura me blerjen e pasurisë. Kur pjesët e një zëri të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësi të përdorimit të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra (përbërësit kryesor) të pronës, impianteve dhe pajisjeve.

Tokat dhe servituetet mbahen sipas koston së vlerësuar dhe nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi për pasuritë tjera është llogaritur duke përdorur metodën drejtvizore sipas Rregullores për Regjistrimin, kontrollin dhe raportimin e mjeteve themelore në % si në vijim:

Emërtimi	Norma e zhvlerësimit (%)
A - Toka dhe servituetet:	0%
B - Ndërtesat dhe strukturat ndërtimore	5%
C - Rrjeta e ujësjellësit	5%
D - Rrjeta e kanalizimit,	5%
E - Kycje në Ujësjellës,	5%
F - Ujëmatësit,	10%
G - Pajisjet elektrike dhe makinerike,	10%
H - Pajisjet e mirëmbajtës,	20%
I - Automjetet,	20%
J - Pajisjet e IT-se,	20%
K - Pajisjet e zyrave,	20%

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve njihet në vlerën kontabël të zërit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen të trupëzuara përbrenda pasurisë do të rrjedhin në Ndërmarrje dhe kostoja e saj mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të pronës dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

## **2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.4 Prona dhe pajisjet (vazhdim)**

#### iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi vjetor njihet në fitim ose humbje/ pasqyrën e të ardhurave në baza lineare përgjatë jetëgjatësisë të çdo pjese të një zëri të pajisjeve.

### **2.5 Dëmtimi i pasurive jo-financiare**

Ndërmarrja vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që një pasuri mund të jetë rënë në vlerë. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, shumat e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet të përcaktojë masën e humbjes së së dëmtimit (nëse ka) pasurive. Shumat e rikuperueshme e një pasurie është vlera më e lartë ose vlera e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare e drejtë minus kosto e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim dhe të përcaktohet për një pasuri individuale, përveç rastit kur pasuria nuk gjeneron rrjedhje hyrës të parasë të cilat janë të pavarura nga të tjera pasuri ose grup pasurish.

Kur vlera kontabël e një pasurie tejkalon vlerën e rikuperueshme, pasuria është konsideruar e rënë në vlerë dhe është shlyer deri në shumën e rikuperueshme. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të parasë të vlerësuarat janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë. Në përcaktimin e vlerës së drejtë minus koston për të shitur, transaksionet e fundit të tregut merren parasysh, nëse është e mundur. Nëse transaksione të tilla nuk mund të identifikohen, përdoret një model i përshtatshëm vlerësimi.

Humbjet nga rënia në vlerë e operacioneve të vazhdueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave në ato kategori të shpenzimeve të cilat janë në përputhje me funksionin e pasurive të rëna në vlerë.

### **2.6 Njohja fillestare dhe matja**

Përveq të arkëtueshmeve tregtare të cilat nuk përmbajnë në vete përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me cmimin e transaksionit në pajtueshmëri me SNRF 15, të gjitha pasuritë tjera financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të korigjuar pëe koston e transaksionit (aty ku është e zbatueshme). Pasuritë financiare, me përjashtim të pasurive financiare të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në këto kategori:

- Kosto të amortizuara
- Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbje(FVTPL)
- Vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Në periudhat e paraqitura Ndërmarrja nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si :FVOCI dhe FVTPL

### **Matja e mëpasshme**

Për qëllime të matjes së mëpasshme , pasuritë financiare klasifikohen në katër kategori:

- Pasuritë financiare me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit)
- Instrumentet e borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI), ku fitimet ose humbjet kthehen si mosnjohje në pasqyrën e fitimit ose humbjeve;

## **2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.6 Njohja fillestare dhe matja (vazhdim)**

#### **Matja e mëpasshme (vazhdim)**

- Instrumentet e kapitalit në FVOCI, pa kthimin e fitimeve ose humbjeve si mosnjohje në pasqyrën e fitimit ose humbjeve;
- Pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

### **2.7 Instrumentet financiare**

#### **a) Pasuritë financiare**

##### **Pasuritë financiare me koston e amortizuar**

Ndërmarrja mban pasuri financiare vetëm të kategorisë së parë, prandaj kjo kategori është e vetmja e rëndësishme për Ndërmarrjen. Ndërmarrja matë pasuritë financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- Pasuria financiare mbahet brenda një model biznesi me qëllim të mbajtjes së pasurive financiare për mbledhjen e rrjedhave kontraktuale të parasë, dhe
- Kushtet kontraktuale të pasurisë financiare paraqiten në datat e përcaktuara në rrjedhjet e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.

Pasuritë financiare me koston e amortizuar maten më pas duke përdorur metodën e interesit efektiv (NEI) (nëse ka interes) dhe janë subjekt i rënies në vlerë. Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur pasuria çregjistrohet, modifikohet ose ka rënë në vlerë.

Pasuritë financiare të Ndërmarrjesë me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të arkëtueshmet tregtare dhe paraja dhe ekuivalentët e parasë.

##### **Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Përfshijnë balancat e parasë dhe depozitat afatshkurtra. Mbitërheqjet nga bankat që janë të ripagueshme sipas kërkesës (nëse ka) dhe formojnë një pjesë integrale të menaxhimit të parasë së Ndërmarrjesë janë përfshirë si një përbërës i parasë dhe ekuivalentëve të parasë për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë.

##### **Mosnjohja**

Një pasuri financiare (ose, kur është e zbatueshme një pjesë e pasurive financiare ose pjesë të një grupi pasurish financiarë të ngjashme) c'regjistrohet kur:

- Të drejtat për të marrë para nga pasuria kanë skaduar; ose;
- Ndërmarrja ka transferuar të drejtat e saj për të marrë para nga pasuria ose e ka marrë përsipër një detyrim për të paguar rrjedhje të parasë të marra në mënyrë të plotë, pa vonesë materiale për një palë të tretë sipas një marrëveshje 'përçimit'; ose (a) Ndërmarrja ka transferuar kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pasurisë, ose (b) Ndërmarrja as nuk ka transferuar as nuk ka ruajtur kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pasurisë, por ka transferuar kontrollin e pasurisë.

##### **Rënia në vlerë e pasurive financiare**

Ndërmarrja përdor një qasje të thjeshtuar në kontabilizimin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera dhe regjistron kompenzimin për humbje si humbjet e pritshme të kreditit të jetës, Këto janë mangësitë e pritura në flukset e mjeteve monetare kontraktuale, duke pasur

## **2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.7 Instrumentet financiare (vazhdim)**

#### **a) Pasuritë financiare (vazhdim)**

##### ***Rënia në vlerë e pasurive financiare (vazhdim)***

Marrv parasysh potencialin e mosplotësimiit në cdo moment gjatë jetës së instrumentit financiar. Gjatë llogaritjes, kompania përdor përvojen e saj historike, treguesit e jashtëm dhe informacionin e ardhëshëm për të llogaritur humbjet e pritshme të kredisë duke përdorur matricë provizioni.

Në çdo datë të bilancit të gjendjes, Ndërmarrja rishikon vlerën kontabël të pasurive të saj financiare, në mënyrë që të përcaktojë nëse ka ndonjë tregues që ato pasuri kanë pësuar humbje nga rënia në vlerë. Vlerësimi i humbjeve të pritshme nga rënia në vlerë kryhet në baza individuale për të gjitha të arkëtueshmet, pasi që shumat e të arkëtueshmeve tregtare është nga Kompania mëmë.

Ndërmarrja njih një lejim (provizion) për humbjet e pritura kreditore (ECL) për të gjithë instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, kur identifikohet rënia në vlerë. ECL bazohen në diferencën midis rrjedhave kontraktuale të parave të gatshme në përputhje me kontratën dhe të gjitha rrjedhave të parave që Ndërmarrja pret të marrë, zbritur në një përfrim të normës efektive origjinale të interesit. Rrjedhat e parave të pritshme do të përfshijnë rrjedha monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose përmirësime të tjera kreditore që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale, nëse ka ndonjë.

#### **b) Detyrimet financiare**

##### **Njohja fillestare dhe matja**

Detyrimet financiare janë klasifikuar si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kredive dhe huave, apo si derivate të përcaktuara si instrumente mbrojtëse në një mbrojtje efektive, sipas rastit. Ndërmarrja përcakton klasifikimin e detyrimeve të saj financiare në njohjen fillestare. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, në rastin e kredive dhe huave, neto të kostove të transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejtë.

Detyrimet financiare të Ndërmarrjesë përfshijnë të pagueshmet tregtare dhe tjera.

##### **Matja e mëpasshme**

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre si më poshtë:

##### ***Detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes***

Detyrimet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes përfshijnë detyrimet financiare të mbajtura për tregtimin dhe detyrimet financiare të përcaktuara me njohjen fillestare, me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Ndërmarrja nuk ka caktuar ndonjë detyrim financiar pas njohjes fillestare, me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

##### ***Kreditë dhe huazimet***

Pas njohjes fillestare, kreditë dhe huazimet me interes maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave kur detyrimet çregjistrohen, si dhe përmes procesit të amortizimit efektiv të normës së interesit (EIR). Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose primin e blerjes dhe tarifat ose kostot që janë pjesë përbërëse e EIR. Amortizimi i EIR përfshihet në shpenzimet financiare në pasqyrën e të ardhurave.



## **2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.7 Instrumentet financiare (vazhdim)**

#### **(b) Detyrimet financiare (vazhdim)**

##### **Matja e mëpasshme (vazhdim)**

###### ***Mosnjohja/ C'regjistrimi***

Një detyrim financiar çregjistrohet kur obligimi nga detyrimi shkarkohet ose anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës me kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues janë modifikuar në mënyrë thelbësore, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si mosnjohje e detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri, dhe diferenca në vlerat kontabël përkatëse njihet në pasqyrën e të ardhurave.

###### ***Të pagueshmet tregtare dhe tjera***

Detyrimet për tregti dhe shumat e tjera të pagueshme maten me kosto e cila është vlera e drejtë e shumës që do të paguhet në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e marra pavarësisht nëse i faturohen Ndërmarrjesë apo jo.

###### ***Huamarrjet***

Huamarrjet përfshijnë hua të marra nga aksionarët. Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e atribueshme të transaksionit. Pas njohjes fillestare, huamarrjet deklarohen me kosto të amortizuara me çdo ndryshim midis shumës në njohjen fillestare dhe vlerës së shlyerjes që njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjeve mbi një bazë efektive Interesi.

###### ***Netimi i instrumenteve financiare***

Pasuritë dhe detyrimet financiare janë netuar dhe shumat neto e raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar nëse ekziston një e drejtë ligjore aktualisht e zbatueshme për të netuar shumat e njohura dhe ka një qëllim që të shlyhen në bazë neto, ose të realizojnë pasuritë dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht.

### **2.8 Tatimi në të ardhura**

Tatimi parashikohet në pasqyrat financiare në përputhje me rregulloren tatimore të Kosovës e cila aktualisht është në fuqi, Ligji nr. 06/L-105 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave".

Tatimi mbi të ardhurat i ngarkuar në fitim ose humbje për vitin përfshin tatimin aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi aktual është llogaritur në bazë të fitimit të tatueshëm që pritet për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje, sepse ai përjashton zërat e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet tjera dhe atë më tej përjashton zërat që nuk janë të tatueshme ose të zbritshme. Tatime të tjera përveç tatimit në të ardhura janë regjistruar në kuadër të shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë njihet për diferencat midis vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së taksave korresponduese të përdorura në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe kontabilizohen duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit. Ndërmarrja nuk ka paraqitur detyrime të shtyra të tatimit për vitin 2023.

## **2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.9 Stoqet**

Stoqet mbahen në vlerë më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshinë koston direkte lidhur me stoqet dhe ato indirekte që janë shkaktuar për sjelljen e stoqeve në vendndodhjen dhe kushtet e tyre aktuale. Kostoja e stoqeve përfshinë: koston e blerjes së mallit, koston e transportit, detyrimet doganore, akcizën etj.

Vlera neto e realizueshme (VNR) paraqet çmimin e vlerësuar të shitjes për stoqet minus koston e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimeve të nevojshme për të bërë shitjen.

Menaxhmenti i Ndërmarrjesë gjatë vitit monitoron në mënyre periodike çmimet e shitjes me koston e stoqeve dhe në qoftë se çmimi është ulur nën kosto, diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si rënie në vlerë e stoqeve.

Kostoja e stoqeve është e bazuar në metodën mesatare të kostos. Kompensimi i përshtatshëm për rëniet në vlerë njihet në fitim dhe humbje kur ka evidencë objektive që VNR është më e ulët se kostoja.

### **2.10 Paraaja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraaja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paratë në dorë dhe paratë e pakufizuara të mbajtura nga banka ose depozita me afat maturimi më pak se tre muaj.

### **2.11 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për mallërat dhe shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit, duke zbritur zbritur zbritjet dhe taksat e lidhura me shitjet.

Të ardhurat njihen kur kontrolli i mallrave ose shërbimeve transferohet tek klienti në një shumë që reflekton kompensimin që Ndërmarrja pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të këtyre mallrave ose shërbimeve për një klient (në përputhje me SNRF 15).

Ndërmarrja njihet detyrimet e kontratës për shumën e marrë në lidhje me kushtet e performancës së pakënaqur dhe raporton këto si detyrime të tjera në pasqyrën e pozicionit financiar. Në mënyrë të ngjashme, nëse Ndërmarrja përmmbushë një kusht të performancës para se të marrë shumën, ndërmarrja njihet ose një pasuri të kontratës ose një të arkëtueshme në pasqyrën saj të pozicionit financiar, në varësi të faktit nëse kërkohet diçka tjetër përveç kohës së kalimit para se të bëhet pagesa.

### **2.12 Transakcionet me valuta të huaja**

Transakcionet në valuta të tjera nga valuta funksionale (valuta të huaja) janë të regjistruara me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e transakcioneve. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin që mbizotëron në datën e bilancit. Zërat jomonetarë që maten në termat e kostos historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja e zërave monetarë, dhe mbi kthimet e zërave monetarë, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës.

**K.R.U. MITROVICA SH.A.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**2.13 Përfitimet e punonjësve**

Ndërmarrjanë rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa në emër të vet dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionin e detyrueshëm sipas legjislacionit lokal. Shpenzimet e bëra në emër të Ndërmarrjesë janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin .

**2.14 Zotimet dhe kontingjencat**

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato nuk shpalosen vetëm nëse mundësia e rrjedhës së parasë që trupëzon përfitimet ekonomike është e largët. Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes kontingjente njihet si provizion nëse Ndërmarrja ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarje të kaluar, është e mundshme që një dalje e burimeve të trupëzuara në përfitimet ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit.

**2.15 Gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël të njësisë ekonomike**

Në procesin e zbatimit të politikave të kontabël të Ndërmarrjesë, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë gjykime që mund të kenë efekte të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare në këtë vit financiar.

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe shpalosjet e detyrimeve kontingjente në fund të periudhës raportuese. Pasiguria rreth këtyre supozimeve dhe vlerësimeve mund të rezultojë në rezultate që kërkojnë një rregullim material të vlerës kontabël të pasurisë ose detyrimit të ndikuar në periudhat e ardhshme.

Supozimet kryesore lidhur me të ardhmen dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e raportimit, që kanë një risk të rëndësishëm në shkaktimin e një rregullimi material në vlerat kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë diskutuar më poshtë. Ndërmarrja bazon supozimet dhe vlerësimet e saj në parametrat në dispozicion, kur janë përgatitur pasqyrat financiare. Rrethanat dhe supozimet ekzistuese në lidhje me zhvillimet e ardhshme, megjithatë, mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve të tregut ose rrethanave që dalin jashtë kontrollit të Ndërmarrjesë. Këto ndryshime pasqyrohen në supozimet kur ato ndodhin.

(i) shënimi 7 – stoqet

(ii) shënimi 19 – tatimi në fitim

**2.16 Qiratë**

Në fillimin e një kontrate, Ndërmarrja vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Kjo do të thotë nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të pagesës.

**Ndërmarrja si qiramarrëse**

Ndërmarrja zbaton një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiratë, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave të pasurive me vlerë të ulët. Ndërmarrja njeh detyrimet e qirasë për të bërë pagesa qiraje dhe të drejtën e përdorimit të pasurive që përfaqësojnë të drejtën e përdorimit të pasurive themelore.

## **2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.16 Qiratë (vazhdim)**

#### **Ndërmarrja si qiramarrëse (vazhdim)**

##### ***i) E drejta e përdorimit të pasurive***

Ndërmarrja njihet të drejtën e përdorimit të pasurive në datën e fillimit të qirasë (d.m.th., data kur pasuria në fjalë është në dispozicion për përdorim).

E drejta e përdorimit të pasurive matet sipas kostos, minus çdo zhvlerësim të akumuluar dhe humbje nga rënia në vlerë, dhe rregullohen për çdo ri-matje të detyrimeve të qirasë. E drejta e përdorimit të pasurive përfshin shumën e njohur të detyrimeve të qirasë, kostot fillestare direkte të bëra dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit minus çdo stimul i marrë nga qiraja. E drejta e përdorimit të pasurive zhvlerësohet mbi një bazë lineare përgjatë afatit më të shkurtër të qirasë dhe jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurive, si më poshtë:

##### ***ii) Detyrimet e Qirasë***

Në datën e fillimit të qirasë, Ndërmarrja njihet detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që duhen bërë gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fikse (përfshirë pagesat fikse në thelb) minus çdo stimul të qirasë të arkëtueshme, pagesa variabile të qirasë që varen nga një indeks ose një normë dhe shumat që pritet të paguhet nën garancitë e vlerës së mbetur. Pagesat e qirasë gjithashtu përfshijnë çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje të arsyeshëm që do të ushtrohet nga Ndërmarrja dhe pagesa të gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron Grupin që ushtron opsionin e përfundimit.

Pagesat e ndryshueshme të qirasë që nuk varen nga një indeks ose një normë, njihen si shpenzime (nëse nuk janë bërë për të prodhuar stoqe) në periudhën në të cilën ndodh ngjarja ose kushti që shkakton pagesën.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, të zbritura duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, norma rritëse e huamarrjes së Ndërmarrjesë.

Pas datës së fillimit, shumat e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar mbledhjen e interesit dhe zvogëlohet për pagesat e qirasë të bëra. Për më tepër, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë ri-matet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (p.sh., ndryshimet në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar të tilla pagesa të qirasë) ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë pasurinë në fjalë.

### **3. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMI I TYRE**

**Zbatimi fillestar i ndryshimeve të reja të standardeve ekzistuese efektive për periudhën aktuale të raportimit**

#### **i) Standardet dhe Interpretimet në fuqi në periudhën aktuale**

Në vitin aktual, Kompania ka aplikuar një sërë ndryshimesh në SNRF-ve të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë në fuqi për periudhën raportuese që fillon më ose pas 1 janarit 2023. Miratimi i tyre nuk ka pasur ndonjë material ndikim në dhënien e informacioneve shpjeguese ose në shumat e raportuara në këto pasqyra financiare.

- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimit"** botuar nga BSNK më 18 maj 2017. Standardi i ri kërkon që detyrimet e sigurimit të maten me një vlerë aktuale të përmbushjes dhe ofron një qasje më uniforme matje dhe paraqitje për të gjitha kontratat e sigurimit. Këto kërkesa janë krijuar për të arritur qëllimin e një kontabiliteti konsistent dhe të bazuar në parime për kontratat e sigurimit. SNRF 17 zëvendëson SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" dhe interpretimet përkatëse kur zbatohet. Ndryshimet në SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" të lëshuara nga BSNK më 25 qershor 2020 shtyjnë datën e zbatimit fillestar të SNRF 17 me dy vjet, për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2023. Për më tepër, ndryshimet e lëshuara më 25 qershor 2020 paraqesin thjeshtime dhe sqarime të disa kërkesave në Standard dhe ofrojnë lehtësira shtesë kur zbatohet SNRF 17 për herë të parë.
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare" - Dhënia e informacioneve shpjeguese** të politikave kontabël të publikuara nga BSNK më 12 shkurt 2021. Ndryshimet kërkojnë që kompanitë të japin informacion shpjegues për politikat e tyre kontabël materiale në vend të politikave të tyre të rëndësishme kontabël dhe të ofrojnë udhëzime dhe shembuj për të ndihmuar përgatitësit të vendosin se cilat politikat kontabël të shpalosen në pasqyrat e tyre financiare.
- **Ndryshimet në SNK 8 "Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet"** - **Përkufizimi i vlerësimeve kontabël** të publikuar nga BSNK më 12 shkurt 2021. Ndryshimet fokusohen në vlerësimet kontabël dhe ofrojnë udhëzime se si të bëhet dallimi midis politikave kontabël dhe vlerësimeve kontabël.
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat"** - **Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm** i lëshuar nga BSNK më 6 maj 2021. Sipas ndryshimeve, përjashtimi nga njohja fillestare nuk zbatohet për transaksionet në të cilat, edhe differencat e përkoshme të zbritshme dhe të tatueshme, lindin në njohjen fillestare që rezultojnë në njohjen e barabartë të pasurive dhe detyrimeve tatimore të shtyra.
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat"** - **Reforma Ndërkombëtare e Tatimeve - Rregullat Model Shtylla e Dytë** të lëshuara nga BSNK më 23 maj 2023. Ndryshimet prezantuan një përjashtim të përkohshëm nga kontabilizimi për tatimet e shtyra që rrjedhin nga juridiksionet që zbatojnë rregullat globale tatimore dhe kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese rreth ekspozimit të kompanisë ndaj taksave mbi të ardhurat që rrjedhin nga reforma, veçanërisht përpara se legjislacioni që zbaton rregullat të jetë në fuqi.

Miratimi i këtyre standardeve të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi nuk kanë çuar në ndryshime materiale në pasqyrat financiare të kompanisë.

**ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMI I TYRE (vazhdim)**

**ii) Standardet dhe ndryshimet në standardet ekzistuese akoma jo-efektive**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese u nxorën nga BSNK mirëpo nuk janë akoma efektive:

- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë" - Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe rimarrja me qira** të lëshuar nga BSNK më 22 shtator 2022. Ndryshimet në SNRF 16 kërkojnë që një shitës-qiramarrës të masë më pas detyrimet e qirasë që rrjedhin nga një rimarrje me qira në një mënyrë që ai të mos njohë asnjë shumë të fitimit ose humbjes që lidhet me të drejtën e përdorimit që ruan. Kërkesat e reja nuk e pengojnë një shitës-qiramarrës që të njohë në fitim ose humbje çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesëshëm ose të plotë të qirasë.
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare" - Klasifikimi i Detyrimeve afatshkurtëra ose afatgjata** të lëshuara nga BSNK më 23 janar 2020 dhe **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare" - Detyrimet afatgjata të kushtëzuara** të lëshuara nga BSNK më 31 tetor 2022. Ndryshimet e lëshuara në janar 2020 ofrojnë një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në fuqi në datën e raportimit. Ndryshimet e nxjerra në tetor 2022 sqarojnë se si kushtet të cilat një kompani duhet të përmbushë brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës raportuese ndikojnë në klasifikimin e një detyrimi dhe caktojnë datën efektive për të dy ndryshimet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024.
- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Rrjedhës së Parasë" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese" - Marrëveshjet financiare të furnizuesve** të lëshuara nga BSNK më 25 maj 2023. Ndryshimet shtojnë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese dhe "tabela sqaruese" brenda kërkesave ekzistuese për dhënie informacionesh shpjeguese cilësore dhe sasiore në lidhje me marrëveshjet financiare të furnizuesit.
- **Ndryshimet në SNK 21 "Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor" - Mungesa e këmbyeshmërisë** të lëshuar nga BSNK më 15 gusht 2023. Ndryshimet përmbajnë udhëzime për të specifikuar kur një monedhë është e këmbyeshme dhe si të përcaktohet kursi i këmbimit kur nuk është në dispozicion.
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta" - Shitja ose kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët** të lëshuar nga BSNK më 11 shtator 2014. Ndryshimet trajtojnë një konflikt midis kërkesave të SNK 28 dhe SNRF 10 dhe sqarojnë se në një transaksion që përfshin një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, shkalla e njohjes së fitimit ose humbjes varet nëse pasuritë e shitura ose të kontribuara përbëjnë një biznes.

Kompania ka zgjedhur që të mos aplikoj këto standarde, ndryshime dhe interpretime sipas datave të tyre efektive. Kompania parashikon që miratimi i këtyre standardeve të reja dhe ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar.

**K.R.U. MITROVICA SH.A.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023  
*(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

**4. Prona, Pajisjet dhe Makineritë**

Përshkrimi	Toka	Ndertesat	Paisjet, Veturat, Kompjuteret	4a) Investimet në vijim	Totali
<b>Kostoja:</b>					
<b>Me 01 janar 2022</b>	<b>2,599,006</b>	<b>46,949,407</b>	<b>4,397,718</b>	<b>90,677</b>	<b>54,036,808</b>
Shtesë		6,215			6,215
<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b>2,599,006</b>	<b>46,949,407</b>	<b>4,403,933</b>	<b>90,677</b>	<b>54,043,023</b>
Shtesë		1,873,717	126,261		1,999,978
<b>Me 31 dhjetor 2023</b>	<b>2,599,006</b>	<b>48,823,124</b>	<b>4,530,194</b>	<b>90,677</b>	<b>56,043,001</b>
<b>Zhvlersimi i akumuluar:</b>					
<b>Me 01 janar 2022</b>		<b>(23,077,994)</b>	<b>(4,336,504)</b>		<b>(27,414,498)</b>
Zhvlersimi i vitit		(2,347,296)	(27,887)		(2,375,183)
<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	-	<b>(25,425,290)</b>	<b>(4,364,391)</b>	-	<b>(29,789,681)</b>
Zhvlersimi i vitit		(2,440,981)	(30,880)		(2,471,861)
<b>Me 31 dhjetor 2023</b>	-	<b>(27,866,271)</b>	<b>(4,395,271)</b>	-	<b>(32,261,542)</b>
<b>Vlera neto kontabël 31 dhjetor 2022:</b>	<b>2,599,006</b>	<b>21,524,117</b>	<b>39,542</b>	<b>90,677</b>	<b>24,253,342</b>
<b>Vlera neto kontabël 31 dhjetor 2023:</b>	<b>2,599,006</b>	<b>20,956,853</b>	<b>134,923</b>	<b>90,677</b>	<b>23,781,459</b>

**K.R.U. MITROVICA SH.A.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**5. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 përbëhen si më poshtë:

	<b>Me 31 dhjetor 2023</b>	<b>Me 31 dhjetor 2022</b>
Të arkëtueshmet tregtare	26,156,905	25,871,367
<b>Total:</b>	<b>26,156,905</b>	<b>25,871,367</b>

**6. Stoqet**

	<b>Me 31 dhjetor 2023</b>	<b>Me 31 dhjetor 2022</b>
Stoqet	251,509	264,537
<b>Total:</b>	<b>251,509</b>	<b>264,537</b>

**7. Paraja dhe Ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 është paraqitur si më poshtë:

	<b>Me 31 dhjetor 2023</b>	<b>Me 31 dhjetor 2022</b>
Paraja në arkë	19,262	18,903
Paraja në bankë	184,546	13,178
<b>Total:</b>	<b>203,808</b>	<b>32,081</b>

**8. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera**

	<b>Me 31 dhjetor 2023</b>	<b>Me 31 dhjetor 2022</b>
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	1,267,805	1,444,884
<b>Nën-total:</b>	<b>1,267,805</b>	<b>1,444,884</b>
<i>Tjera:</i>		
TVSH e pagueshme	3,547,974	3,574,938
Pagat e Pagueshme	316	125
Të pagueshmet ndaj tatimit në burim	14,674	10,629
Të pagueshmet ndaj kontributeve pensionale	20,228	16,016
Provizionet per rastet e kontesteve	75,447	
Te tjera	9,299	
<b>Total:</b>	<b>4,935,742</b>	<b>5,046,592</b>



**K.R.U. MITROVICA SH.A.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023  
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**9. Detyrimet tjera afatgjata**

Detyrimet tjera afatgjata paraqesin donacionet e marra nga Komisioni Evropian, Projekti CDI etj. Ky regjistrim për raportim financiar është trajtuar sipas SNK 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndihmën Qeveritare

	<b>Me 31 dhjetor 2023</b>	<b>Me 31 dhjetor 2022</b>
Asetet- Grantet para periudhes	17,900,882	19,156,437
Asetet Grantet e Periudhes	1,926,090	450
Te hyrat e njohura gjate vitit	(1,345,905)	(1,256,005)
Rregullimet per vitet e kaluara	(553,819)	-
<b>Total:</b>	<b>17,927,247</b>	<b>17,900,882</b>

**10. Kapitali Aksionar**

<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2023</b>	<b>2022</b>
<b>Aksionari</b>	<b>Kapitali në %</b>	<b>Kapitali në %</b>
Qeveria e Kosovës	100%	100%
<b>Total në %</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

**11. Të hyrat**

Të hyrat nga shitja më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023</b>	<b>Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022</b>
Te hyrat nga shitja	4,997,076	5,099,343
Të hyrat nga shërbimet	29,612	40,554
Te hyra tjera	1,399,008	1,639,135
<b>Total:</b>	<b>6,425,696</b>	<b>6,779,032</b>

**K.R.U. MITROVICA SH.A.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**12. Kosto e mallit të shitur**

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Uji I blere me shumice	565,402	564,371
Shpenzimet e analizave eksterne të ujit	11,378	9,468
Klori I gazte - KEMIKALE	149,563	80,460
Alumin Sulfat	12,596	5,404
<b>Total:</b>	<b>738,938</b>	<b>659,702</b>

**13. Shpenzimet e shpërndarjes**

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Shpenzimet e derivateve të naftes	36,813	38,406
Shpenzimet e autogomave	1,201	466
Anetaresia ne SHUKOS	11,172	10,700
Shpenzimet per sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve	8,478	7,324
Shpenzimet e Reklames	969	
Shpenzimet e mirembajtjes	59,123	48,387
Shpenzimet e zhvlerësimit	2,471,861	2,375,183
<b>Total:</b>	<b>2,589,618</b>	<b>2,480,465</b>

**14. Shpenzimet e personelit**

Përfitimet e punëtorëve për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
<b>Shpenzimet e pagave</b>		
Pagat Bruto	2,107,566	1,904,070
Kontributi pensional punedhënesi	105,232	94,857
<b>Total:</b>	<b>2,212,798</b>	<b>1,998,927</b>

**K.R.U. MITROVICA SH.A.****SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

*(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***15. Shpenzimet administrative – Komunalitë**

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Shpenzimet e Energjise Elektrike	770,205	722,032
Shpenzimet e Telefonit	8,628	7,316
Shpenzimet e Internetit	1,712	1,806
Shpenzimet e Mbeturinave	197	704
Shpenzimet e tatimit ne prone dhe taksa e firmes	867	5,414
<b>Total:</b>	<b>781,609</b>	<b>737,272</b>

**16. Shpenzimet administrative - tjera**

Shpenzimet tjera administrative për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, përbëhen si më poshtë:

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Shpenzimet e qirase	17,055	17,363
Shpenzimet e zyres Rregullatore	41,726	39,169
Shpenzimet materiale	47,933	18,387
Shpenzimet per pjesmarrje ne Konferenca	4,925	-
Shpenzimet e zyres	1,081	915
Shpenzimet e anetaresimit	1,154	414
Shpenzimet per provizionimin e kontesteve	75,447	-
Shpenzimet - konkurset (publikimet)	2,840	1,829
Shpenzimet e provizionit bankar	7,198	5,247
Shpenzimet e auditimit	1,740	1,850
Shpenzimet e permbaruesit	43,072	46,113
Shpenzimet e reprezentacionit	11,888	5,233
Shpenzimet per udhetim zyrtar	7,075	500
Shpenzimet e borxhit te keq	320,251	659,456
Shpenzimet per shendet dhe siguri	1,440	-
Shpenzimet tjera	5,847	1,444
<b>Total:</b>	<b>590,670</b>	<b>797,921</b>

**17. Shpenzimet financiare**

	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Shpenzimet e interesit (vonesa ne pagesa)	9,044	19,157
<b>Total:</b>	<b>9,044</b>	<b>19,157</b>

**K.R.U. MITROVICA SH.A.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023  
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**18. Shpenzimet e tatimit në fitim**

Sipas ligjit nr. 03/L-162 "Mbi tatimin në të ardhurat e korporatave", në fuqi nga 1 janar 2010, norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave ka qenë 10%.

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2023	2022
<b>(Humbja kontabël për vitin</b>	<b>(496,982)</b>	<b>85,589</b>
Shpenzimet e papanuara		
Humbjet e bartura nga viti kaluar	(854,104)	(939,693)
<b>Fitimi i tatueshëm</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzimet e tatimit në fitim</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**19. Transaksionet me palët e lidhura**

Një person ose një palë e afërt e familjes së atij personi është e lidhur me Kompaninë raportuese nëse ai person:

- i. ka kontroll ose kontroll të përbashkët mbi Kompaninë raportuese; ka kontroll ose kontroll të përbashkët të Kompanisë raportuese;
- ii. ka ndikim të rëndësishme mbi Kompaninë raportuese; ose
- iii. është anëtar i menaxhmentit kyq të Kompaninë raportuese ose mëmë të Kompanisë raportuese.

Një entitet është i lidhur me Kompaninë raportuese nëse ndonjë prej kushteve të mëposhtme aplikohet:

- i. Entiteti dhe Kompania raportuese janë anëtare të të njëjtit grup (që do të thotë që çdo entitet mëmë, filialë dhe degë filiale është e lidhur me të tjerët).
- ii. Entiteti është shoqëri ose ndërmarrje e përbashkët e entitetit tjetër (ose një shoqëri apo ndërmarrje e përbashkët e një anëtari të grupit në të cilën shoqëria tjetër është anëtar).
- iii. Të dyja entitetet janë ndërmarrje të përbashkëta të së njëjtës palë të tretë.
- iv. Njëri entitet është ndërmarrje e përbashkët e e palës së tretë dhe entiteti tjetër është shoqëri e entitetit të tretë.
- v. Entiteti është një plan përfitimi pas punësimit për përfitimet e punëtorëve të entitetit raportues ose një entiteti të lidhur me entitetin raportues. Nëse entiteti raportues është një plan I tillë, punëtorët sponsorues janë gjithashtu të lidhur me entitetin raportues.
- vi. Entiteti është i kontrolluar ose ka kontroll të përbashkët nga një person i afërt ose një anëtar i afërt i familjes së atij personi.
- vii. Një person i lidhur ka ndikim të rëndësishëm mbi entitetin ose është anëtar i menaxhmentit kyq të entitetit (ose Kompanisë mëmë të entitetit).

Një transaksion me një palë të lidhur është një transfer i resurseve, shërbimeve ose obligimeve mes Kompanisë raportuese dhe një palë të lidhur, pavarësisht nëse çmimi është ngarkuar.

Gjatë vitit Kompania kishte transaksione me palët e ndërlidhura si në vijim:

	2023	2022
<b>Pagat për Bordin dhe Kryeshefin:</b>		
Pagat për Bordin (Bruto)	16,128	11,474
Paga vjetore e Kryeshefit Ekzekutiv (Bruto)	21,537	20,088

**K.R.U. MITROVICA SH.A.****SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***20. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut****a. Politikat e rëndësishme kontabël**

Detajet e politikave kontabël dhe metodave të aplikuara, duke përfshirë kriterin e njohjes, bazën e matjes dhe bazën në të cilën njihen të hyrat dhe shpenzimet, në lidhje me secilën klasë të pasurisë financiare, detyrimet financiarë dhe instrumentit të kapitalit janë të shpalosura në shënimin 3 të pasqyrave financiare.

**b. Kategoritë e instrumenteve financiare**

Në fund të vitit 2023 dhe 2022 kompania kishte këto instrumente financiare:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
<b><u>Pasuritë financiare:</u></b>		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	26,156,905	25,871,367
Stoqet	251,509	264,537
Paraja dhe ekuivalentët e pasasë	203,808	32,081
<b>Totali</b>	<b><u>26,612,222</u></b>	<b><u>26,167,985</u></b>
<b><u>Detyrimet financiare:</u></b>		
Llogaritë e pagueshme tregtare	4,935,742	5,046,592
<b>Totali</b>	<b><u>4,935,742</u></b>	<b><u>5,046,592</u></b>

**c. Objektivat e menaxhimit të rrezikut financiar**

Aktivitetet e kompanisë e ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë dhe rreziqet që lidhen me efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit në valutë të huaj dhe në normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të kompanisë përqendrohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të kompanisë.

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga menaxhimi i kompanisë bazuar në disa politika dhe procedura të shkruara të paracaktuara me shkrim që mbulojnë menaxhimin e përgjithshëm të rrezikut, si dhe fusha specifike, siç janë rreziku i këmbimit valutor, rreziku i normës së interesit, rreziku i kredisë, përdorimi i letrave me vlerë të përshtatshme dhe menaxhimi i likuiditetit të tepërt.

**d. Rreziku i tregut***Rreziku i valutës së huaj*

Rreziku i valutave të huaja është rreziku që vlera e instrumenteve financiare ndryshon për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit të huaj kompania operon ndërkombëtarisht dhe është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit valutor që vjen nga ekspozimet e ndryshme të monedhës. Kompania nuk përdor asnjë instrument për të mbrojtur rrezikun e këmbimit valutor. Menaxhmenti i kompanisë është përgjegjës të ruajë pozicionin e duhur neto në secilën monedhë në total dhe operacionet e tij monitorohen çdo ditë nga menaxhmenti i kompanisë.

Kompania ndërmerr transaksione si në Euro ashtu edhe në valutë të huaj (rrallë herë). Mirëpo gjatë vitit 2023 dhe 2022 kompania nuk ka hyrë në transaksione të këtilla.

**K.R.U. MITROVICA SH.A.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**21. Vlera e drejtë dhe Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)**

**d. Rreziku i tregut (vazhdim)**

*Rreziku i normës së interesit*

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e një instrumenti financiar të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikun që maturitetet e pasurive me interes ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes që përdoren për të financuar ato pasuri (rivlerësimi rrezikut). Kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit pasi që kompania nuk ka ndonjë detyrim të interesit në periudhën raportuese.

**e. Rreziku kreditorë**

Rreziku kreditor është rreziku i humbjeve financiare të kompanisë nëse klienti apo pala tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale. Sasia e ekspozimit të kredisë në lidhje me këtë, është paraqitur në vlerat kontabël të pasurive në pasqyrën e pozicionit financiarë. Llogaritë e arkëtueshme tregtare monitorohen në baza ditore dhe konsumatorët paralajmërohen menjëherë.

Vlera kontabël e pasurisë financiare në pasqyrat financiare, që nuk ndikohet nga humbjet, nëse ka, paraqet maksimumin e ekspozimit të kompanisë ndaj rrezikut kreditorë.

**f. Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që kompania do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve të lidhura me detyrimet financiare që lidhen me dhënie të mjeteve monetare ose ndonjë pasurie tjetër financiare. Rreziku i likuiditetit mund të ndodhë si rezultat i financimit të pasurive afatgjata me burime afatshkurtëra.

Kompania e monitoron likuiditetin e saj në baza mujore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj në momentin kur ato skadojnë.

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
<b><u>Pasuritë financiare:</u></b>		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	26,156,905	25,871,367
Stoqet	251,509	264,537
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	203,808	32,081
<b>Totali</b>	<b><u>26,612,222</u></b>	<b><u>26,167,985</u></b>
<b><u>Detyrimet financiare:</u></b>		
Llogaritë e pagueshme tregtare	4,935,742	5,046,592
<b>Totali</b>	<b><u>4,935,742</u></b>	<b><u>5,046,592</u></b>
<b>Hapësira e Likuiditetit</b>	<b><u>21,676,480</u></b>	<b><u>21,121,393</u></b>

**g. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare**

Menaxhmenti i kompanisë konsideron se vlera kontabël e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare janë të regjistruara mbi koston apo në koston e amortizuar në pasqyrat financiare përfaqësojnë vlerat e tyre të drejta për shkak të maturimit të tyre të shkurtër.

**K.R.U. MITROVICA SH.A.**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023  
(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**21. Kontigjencat dhe zotimet**

***Detyrimet ndaj tatimeve***

Pasqyrat financiare dhe regjistrimet kontabël të kompanisë nuk janë audituar nga autoritetet e taksave për periudhën 01 janar 2023 – 31 dhjetor 2023 kështu që obligimet tatimore të Ndërmarrjes nuk mund të konsiderohen si të përfunduara.

Kompania nuk ka paraqitur në pasqyrat financiare dënimin nga Administrata tatimore e Kosovës për vitin 2012 në vlerë 113,303 Euro, 2013: 335,847 dhe 2014: 20,299 Euro për shkak se ekziston vendimi që është fituar në shkallën e parë dhe Kompanitë e njëjta e kanë fituar tërësisht.

***Çështjet gjyqësore***

Me 31 dhjetor 2023, Kompania ka çështje gjyqësore të hapura dhe janë njohur provizionime për to.

***Zotimet e qirasë operative:***

<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2023</b>	<b>2022</b>
Pagesa brenda një viti	14,781	14,781
Pagesa më shumë se një vit ose më pak se pesë vite	18,352	33,133

**22. Ngjarjet pas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje tjera domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregulime ose shpalosje në pasqyrat financiare.